

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

DREJTORIA E MBROJTJES DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. 4411 Prot.

Rrogozhinë, më 14/10 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë / / 2025

"Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë"

Komisioni I ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr 366 datë 06.10.2025 nga Kryetari I Bashkisë "Për verifikimin e familjeve që jetojnë në gjendje të vështire ekonomike" ,mbështetur në Ligjin Nr 139 datë 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" VK B nr. 64 ,dt.23.12.2024 "Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025" ,Ligjin Nr. 10296 ,datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" Udhëzimi Nr.2 datë 06.02.2012 "Për Proçedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit", të nenit 21 ,të Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" I ndryshuar Vendimit të Këshillit Nr. 38 ,datë 20.06.2018 "Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për familjet në nevojë që do të trajtohen mendihmë financiare me fondet e buxhetit vendor nga Bashkia Rrogozhinë". I propozon Këshillit të Bashkisë:

Të Vendosë

1. Të akordohet një ndihmë e menjëhershme ekonomike në shumën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë për secilën nga familjet e poshtëshënuara ,ku do të përballohet nga Ndihma Ekonomike të Bashkisë Rrogozhinë të vitit 2025 (Llogaria 606 -1004).

Përfutuesit :

- Izet Fetah Kaja , familje me të ardhura të pamjaftueshme Njësia Administrative Kryevindh .
- Nazmi Qerim Saraçi , familje me të ardhura të pamjaftueshme Njësia Administrative Gosë.
- Shkëndije Beqir Saraçi ,familje me të ardhura të pamjaftueshme Njësia Administrative Gosë.

2. Për Zbatimin e këtij vendimi pas miratimit në Këshillin Bashkiak, ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Komisioni I ngritur nga Kryetari I Bashkisë .

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Komisioni

Ledian Hasani

Dorina Maçolli

Brunilda Gjuzi

KRYETAR

Edison MEMOLLA

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA E MBROJTJES DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. 441 / Prot.

Rrogozhinë, më 14 / 10 / 2025

RELACION

**MBI PROJEKT – VENDIMIN, “PËR DHËNIEN E NDIHMËS SË MENJËHERSHME
EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË”**

Të nderuar Këshilltarë ,

Komisioni I ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr 366 datë 06.10.2025 nga Kryetari I Bashkisë “Për verifikimin e familjeve që jetojnë në gjendje të vështire ekonomike ” VK B nr. 64 ,dt.23.12.2024 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025”. ,mbështetur në Ligjin Nr 139 datë 17.12.2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr. 10296 ,datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Udhëzimi Nr.2 datë 06.02.2012 “Për Proçedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, të nenit 21 ,të Ligjit Nr. 9355,datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” *I ndryshuar* Vendimit të Këshillit Nr. 38 ,datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë financiare me fondet e buxhetit vendor nga Bashkia Rrogozhinë”. I propozon Këshillit të Bashkisë:

Referuar sa më sipër Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social së bashku me komisionin e ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.366 datë 06.10.2025 “Për verifikimin e familjeve që jetojnë në vështirësi ekonomike”, ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim këtë projekt-vendim për një ndihmë të menjëhershme ekonomike për familjet e z.Izet Fetah Kaja, Nazmi Qerim Saraçi, Shkëndije Beqir Saraçi , në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për secilën nga familjet e lartëpërmendura për të përballuar sa do pak situatën e vështirë ekonomike në të cilën ndodhen nga Bashkia Rrogozhinë. Nga vizita e kryer në banesën e z.Izet Fetah Kaja rezultoi gjendja si më poshtë: Familja është e përbërë nga katër anëtarë që bashkëjetojnë në kushte tërësisht të papërshtatshme, në një dhomë të vetme. Banesa si strukturë është e ndërtuar me fonde të tërmetit, por ka mbetur prej vitesh në atë gjendje. Bëhet fjalë për një situatë të rënduar sociale dhe shëndetësore, ku secili prej anëtarëve përballlet me vështirësi të theksuara. Gruaja e familjes në fjalë vuan nga probleme serioze shëndetësore, pasi është operuar nga kanceri i gjirit (Carcinoma), gjë që ka ndikuar ndjeshëm në aftësinë e saj për të punuar e kontribuar në mirëqenien familjare. Në të njëjtën banesë ndodhet edhe nëna e bashkëshortit, një e moshuar, e cila qëndron në shtrat dhe kërkon kujdes të vazhdueshëm. Djali i familjes, Arturi është person me aftësi të kufizuara (paraplegjik me kujdestari) gjë që në nënkupton nevojë të vazhdueshme për përkujdesje dhe mbështetje fizike, emocionale dhe ekonomike. Për familjen e z. Nazmi Saraçi , familja është në kushte të vështira ekonomike , një ndër femijet Roland Saraçi që është i semur me p.a.k me diagnozë (spectri i crregullimit autik dhe epilepsi) mer pagesë 14565 dhe kujdestari nëna Nafije Saraçi 11652



Nga verifikimi qe kemi bere ne banesen e e tij nuk eshte ne kushte te pershtatshme per jetese ,ndërsa për sa I përket familjes së znj. Shkëndije Saraçi I ka ndoshur një fatkeqësi ku banesa është djegur plotësisht nga zjarri.

Gjendur në këto kushte të vështira ekonomike vlerësuam që familjet e latëpërmendura të trajtohet me një ndihmë ekonomike në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për secilën familje për ti ardhur sa do pak në ndihmë për kushtet e vështira në të cilën ndohen familjet, pika 2 e Vkb nr 38 dt.20.06.2018

Për sa më lart kërkojmë miratimin nga ana e Këshillit Bashkiak të këtij projekt-vendimi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I MBROJTJES DHE KUJDESIT SOCIAL

LEDIAN HASANI